



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 13 nëntor 2024

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës; në mbështetje të rregullit 17 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr.01/2023; si dhe në mbështetje të Rregullores nr. 06/2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 02/2022 për punën praktike në Gjykatën Kushtetuese, më qëllim të edukimit profesional në fushën juridike të gjyqimit dhe të interpretimit kushtetuese, Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës shpall publikisht:

**SHPREHJEN E INTERESIT
për angazhimin e praktikantëve**

Pozita: Praktikant

Numri i pozitave: 5 (pesë)

Kohëzgjatja e praktikës: Një (1) vit

Detyrat kryesore

- Detyrat kryesore të punës së praktikantit janë si në vijim:
 - angazhohet në punën e këshilltarëve kushtetues juridik dhe të gjyqtarëve;
 - mbledh dhe studion literaturë përkatëse ligjore, informacione dhe dokumente sipas kërkesës nga këshilltarët ligjor dhe nga gjyqtarët;
 - përgatit analiza krahasuese nën udhëheqjen e këshilltarëve kushtetues juridik;
 - hulumton praktikat dhe vendimet e gjykatave tjera kushtetuese dhe ato të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
 - mirëmban dhe përditëson shënimet përkatëse të databazave të Gjykatës;
 - përkujdeset për fajllimin e dokumentacionit përkatës, skenimit, fotokopjimit të materialeve të nevojshme sipas kërkesës; dhe
 - kryen punë të tjera profesionale sipas kërkesës së Kryetarit, Këshilltarit të Parë apo Gjyqtarëve, apo Mbikëqyrësit të praktikantëve.

Kualifikimet dhe aftësitë

- Të drejtë aplikimi për pozitën e praktikantit kanë të gjithë kandidatët që
 - të janë shtetas të Republikës së Kosovës;
 - kanë zotësi të plotë për të vepruar;
 - zotërojnë njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë si dhe kanë njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze;

- iv. kanë diplomuar në fakultetin juridik në njërin nga universitetet në Kosovë, kanë diplomë të fakultetit juridik të nostrifikuar në Kosovë, ose janë në vitin e fundit të studimeve në fakultetin juridik; dhe
- v. demonstrojnë shkathtësi solide kompjuterike.

Informata të përgjithshme për kandidatët

Shuma e kompensimit material të praktikantëve do të jetë ekuivalente me pagën minimale në Republikën e Kosovës në vitin e angazhimit të praktikantit.

Para kalimit të afatit kohor për të cilin janë pranuar në Gjykatë, praktikantët i nënshtrohen vlerësimit të njohurive të fituara gjatë punës praktike.

Pas përfundimit të periudhës vlerësuese, praktikanti pajiset me certifikatë me të cilën dëshmohet kryerja e suksesshme e punës praktike në Gjykatë.

Gjykata ofron mundësi të barabarta të angazhimit për gjithë kandidatët aplikues.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin publik të Republikës së Kosovës.

Procedura e konkurrimit:

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin formularin e aplikimit, të shoqëruar nga një jetëshkrim (CV), një letër motivuese dhe dokumentacionin përkatës i cili dëshmon përgatitjen shkollore.

Formulari i aplikimit mund të merret në kopje fizike në recepcionin e Gjykatës Kushtetuese dhe mund të shkarkohet nga ueb-faqja e Gjykatës Kushtetuese: www.gjk-ks.org. Aplikacionet e dorëzuara pa formularin zyrtar refuzohen.

Aplikacioni me të gjitha dokumentet e kërkuara mund të dorëzohet nëpërmjet emailit në adresën: gjk.burimetnjerezore@gjk-ks.org, nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në kopje fizike në Departamentin e Administratës dhe Burimeve Njerëzore (DABNJ) të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Adresa: *Perandori Justinian 44, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës*).

Konkursi mbetet i hapur tridhjetë (30) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Gjykatës si dhe shpalljes publike, duke filluar nga data 13.11.2024 deri më datën 13.12.2024.

Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është 13.12.2024, deri në orën 16:00.

Shënim:

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit dhe jo të plota refuzohen.